

## Si mund të kujtohem që të marr ilaçet e mia?

Nuk është gjithmonë e lehtë! Ju do t'i merrni ilaçet tuaja të TB-së për një periudhë të gjatë (6 muaj ose më shumë), kështu që do t'ju bëhet rutinë. Këtu keni disa mënyra për të kujtuar marrjen rregullisht të ilaçeve tuaja:

- Merrini ilaçet çdo ditë në të njëjtën kohë dhe lëroni ato në të njëjtin vend.
- Vendosini pilulat në një enë që mban për ilaçe për një javë.
- Shënoni në një kalendar çdo ditë që ju merrni ilaçet.
- Përpikuni të vendosni një alarm që t'ju kujtojë për të marrë ilaçet.
- Kërkojani një anëtar të familjes ose një miku t'ju kujtojë marrjen e ilaçeve, dhe nëse përsëri harroni, doktori ose infermiera juaj mund t'ju kërkojnë që t'ju shohin tek merrni ilaçet.
- Tregojini doktorit ose infermieres suaj nëse nuk e keni marrë një dozë të ilaçit - ata nuk do të inatosen dhe do të përpiqen që t'ju ndihmojnë.

Gjithashtu ju duhet të ndiqni të gjitha takimet tuaja në klinikë! Doktori ose infermiera juaj duhet që t'ju shohin si po ecni me mjekimin.

## Më shumë informacion rreth tuberkulozit

Nëse keni TB dhe doni të mësoni më shumë rreth tij nga dikush që e ka kaluar këtë sëmundje, ekziston një libër i titulluar "The Tuberculosis Survival" (Manuali i mbijetesës nga tuberkulozi) nga Paul Mayho (botimi i dytë). Libri kushton 14,95 GBP dhe gjendet në libraritë lokale, te kompania Gazelle e shërbimeve të shpërndarjes së librit, dhe në [www.amazon.co.uk](http://www.amazon.co.uk), ose drejtpërdrejt nga botuesit, në faqen e internetit [www.meritpublishing.com](http://www.meritpublishing.com) të kompanisë Merit Publishing International ose duke dërguar një e-mail në adresën [merituk@aol.com](mailto:merituk@aol.com). Numri i referencës për të porositur librin është ISBN 1873413 149.

Mbroni familjen dhe miqtë tuaj nga TB - merrni ilaçet e TB-së

**Mos harroni** se infermiera e tuberkulozit është këtu për t'ju ndihmuar dhe për t'ju këshilluar gjatë të gjithë mjekimit. Ju lutemi kontaktoni infermierën tuaj të tuberkulozit nëse nuk ndiheni mirë gjatë trajtimit tuaj ose nëse ka ndonjë gjë që jeni të pasigurt për mjekimin tuaj.

Infermiera juaj e tuberkulozit është:

Doktori juaj në spital është:

Nr. i kontaktit:

E-maili:

**TB Alert** është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



**TB Alert,**  
Community Base,  
113 Queens Road,  
Brighton BN1 3XG  
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në [www.tbalert.org](http://www.tbalert.org)

Informacioni i dhënë në këtë broshurë për trajtimin e tuberkulozit nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e infermieres/doktorit tuaj të TB-së ose të ndonjë profesionisti tjetër të shëndetësisë. Asnjë nga informacionet që përmban kjo broshurë nuk mendohet të përdoret për të marrë vendime për kurimin e tuberkulozit. Pyetjet dhe shqetësimet lidhur me trajtimin duhet t'i drejtohen një mjeku profesionist të kujdesit shëndetësor.

Punim origjinal kërkimor nga North West London TB Network



## Mjekimi i tuberkulozit

je e madhe gjatë natës  
temperaturë  
e pashpjegueshme në  
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë  
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!  
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë  
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!  
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë  
Gjendra të ënjtura Gjendra të  
Temperaturë!! Humbje e pashpjegueshme në  
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës  
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë



## Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi (TB) është një infeksion bakterial që kryesisht gjendet në mushkëri por që mund të ndikojë çdo pjesë të trupit, si trurin, gjëndrat limfatike, veshkat dhe kockat.

## Si merret tuberkulozi?

Kur kollitet një person me tuberkuloz në mushkëri, mikrobet mund të kalojnë në ajër në formën e piklave të vogla dhe personat e tjerë mund t'i marrin ato me anë të frymëmarrjes. Personat që kanë më shumë gjasa të infektohen me tuberkuloz janë ata që jetojnë në të njëjtën shtëpi ose apartament me personin e infektuar me tuberkuloz.

## A jam infektues?

Jo të gjithë personat me tuberkuloz janë infektues. Ju jeni infektues vetëm nëse keni TB në mushkëri ose në fyt dhe ju kolliteni duke lëshuar mikrobe të TB-së. Ju nuk jeni infektues për të tjerët nëse e keni TB-në në ndonjë pjesë tjetër të trupit përveç mushkërive ose fytyrës. Mjeku/infermierja juaj mund t'ju japë më shumë informacion.

## Si mjekohet tuberkulozi?

Tuberkulozi mjekohet me anë të një kombinimi ilaçesh për të paktën gjashtë muaj. Kohëzgjatja e trajtimit varet nëse mikrobi i tuberkulozit i reziston çfarëdo ilaçi dhe se ku tuberkulozi gjendet në trupin tuaj. Nëse nuk merrni tableta të këshilluara nga doktori juaj, trajtimi mund të zgjatet.

## Cili është mjekimi standard për tuberkulozin?

Doktori ose infermierja juaj e TB-së do t'ju japin katër ilaçe të ndryshme për dy muaj. Ato janë:

- Rifampicin
- Isoniazid
- Pyrazinamide
- Ethambutol

(Isoniazid-i, Rifampicin-a dhe Pyrazinamide mund të kombinohen si Rifater).

Shumica e njerëzve nuk do të jenë infektues pas dy javëve nga marrja e ilaçeve.

Pas dy muajsh, doktori si zakonisht do i reduktojë ilaçet në:

- Rifampicin
- Isoniazid

Rifampicin-a dhe Isoniazid-i mund të kombinohen si Rifater).

## A janë të sigurta ilaçet e TB-së?

Ashtu si me të gjithë ilaçet, mund të ketë efekte anësore. Disa efekte anësore janë të vogla, të tjerat mund të jenë më serioze. Informacion mbi tabletat e ndryshme dhe efektet e tyre anësore, disponohet nga stafi i klinikës së tuberkulozit.

(Rifampicina, Isoniazidi, Pyrazinamida) dhe Ethambutoli mund të merren pa problem edhe gjatë shtatzënisë.

Doktori ose infermierja juaj do të kryejë disa teste përpara se ju të filloni trajtimin.

Ju duhet t'u tregoni atyre nëse jeni duke përdorur ndonjë formë të kontraktivëve hormonalë (nga goja, implant ose lloj tjetër), sepse efekti i tyre ulet kur përdorni Rifater.

## Sa shpesh duhet t'i marr ilaçet e mia?

Ilaçet duhet të merren çdo ditë. Nëse harroni të merrni një dozë, merreni menjëherë sapo të kujtoheni. Nëse ju harroni dhe është koha për të marrë dozën tjetër, lëreni atë që harruat. Mos merrni dozë të dyfishtë. Ju lutemi, tregojini infermieres/doktorit tuaj nëse kjo ndodh.

## Pse duhet ta marr rregullisht ilaçin e TB-së?

Mikrobet e TB-së vriten shumë ngadalë. Duhet të paktën 6 muaj që ilaçet të vrasin të gjitha mikrobet e tuberkulozit. Ju duhet të ndiheni më mirë dhe mund të mos keni më simptoma të tuberkulozit përpara kësaj kohe, por ju duhet të vazhdoni t'i merrni ilaçet derisa doktori ta ndërpresë mjekimin. Ndërprerja e parakohshme e mjekimit, ose marrja jo e rregullt e ilaçeve sipas këshillës së doktorit është e rrezikshme, sepse ju mund të bëheni infektues dhe të zhvilloni një lloj tuberkulozi që është i vështirë dhe ndonjëherë i pamundur për t'u trajtuar.

## A duhet të mënjanoj ndonjë ushqim ose ilaçe të tjera ndërkohë që marr mjekimin e tuberkulozit?

Jo, ju mund të hani çfarëdo që ju pëlqen. Por duhet të evitoni pirjen e tepërt të alkoolit.

Është shumë e rëndësishme që t'i tregoni doktorit nëse jeni duke marrë ilaçe të tjera.